

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6636  
E mërkurë, 22 qershor 2022  
çmimi 0.40 €

## Tre kompromise që mund t'i kërkojnë Kosovës

FAQE 3

Milazim KRASNIQI



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)


facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH  
www.awr-abbruch.de

KOSOVA DHE SERBIA ARRIJNË MARRËVESHJE PËR ENERGIJË

FAQE 4-5

# PA E NDRYSHUAR ASNJË PRESJE, QEVERIA KURTI FINALIZOI MARRËVESHJEN E THAÇIT DHE TË MUSTAFËS PËR ENERGIJË



Delegacioni i Kosovës dhe ai i Serbisë kanë arritur të martën pajtueshmëri për zbatimin e marrëveshjes ekzistuese për energjinë. Takimet janë zhvilluar në Bruksel në kuadër të dialogut për normalizim të marrëdhënieve mes dy shteteve i cili ka nisur më 2011. I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për këtë dialog, Miroslav

Lajçak, marrëveshjen e arritur e ka quajtur "hap të madh". Ndërkaq opozita ka theksuar se kryeministri Kurti qenka pajtuar për planin e zbatimit të marrëveshjes për energji të hartuar në Bruksel më 2015. "Po të njëjtën marrëveshje kryeministri atëbotë e konsideronte tradhti kombëtare", ka thënë nënkryetarja e PDK-së, Vlora Çitaku

## AKTUALE



'ÇDO GJË ËSHTË NË FLAKË': RAJONI LINDOR I UKRAINËS, NËN BOMBARDIME TË VAZHDUESHME F. 2

LEHTËSOHEN PROCEDURAT PËR REGJISTRIM TË STUDENTËVE NDËRMJET KOSOVËS DHE SHQIPËRISË F. 7

NË FERIZAJ REALIZOHEN 73 URDHËRESA TË GJYKATAVE PËR VEPRA PENALE F. 6

## EKONOMI



NUK KALON MOCIONI PËR SHKARKIM TË BORDIT TË ZRRE-SË F. 8

MIRËPRITET NJË HETIM PARLAMENTAR PËR GJENDJEN NË TË CILËN MENAXHMENTET E KALUARA E KANË SJELLË RTK-në F. 8

## SPORT



KOK-U PARAQITI EKIPIN PËR LOJËRAT MESHDETARE 'ORAN 2022' F. 10



### PDK - AAK: TËRHEQJA E PARAVE NGA TRUSTI, E DOMOSDOSHME PËR QYTETARËT

FAQE 7

### KONJUFCA: ASHAK-u, BARTËSE E PROCESIT TË SHTETNDËRTIMIT

FAQE 7



**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni Xhepçisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE  
INFO: 049-111-101, 044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website, Marketing...

## 'Çdo gjë është në flakë': Rajoni lindor i Ukrainës, nën bombardime të vazhdueshme

**KIEV, 21 QERSHOR** - Sulmet e Rusisë shkaktuan zjarre të shumta të martën në rajonet në lindje të Ukrainës. Grupet e rezistencës ukrainase ia mohojnë Moskës kontrollin e plotë ushtarak të rajonit gati katër muaj pasi Kremli nisi pushtimin. "Sot gjithçka që mund të digjet ka marrë flakë", deklaroi Serhiy Haidai, guvernator i rajonit lindor të Luhanskut.

Lufta e Rusisë ka shkaktuar alarm mbi furnizimet ushqimore nga Ukraina drejt pjesës tjetër të botës dhe furnizimet me gaz nga Rusia, si dhe ka ngritur pikëpyetje për sigurinë në Evropën Perëndimore.

Ushtria ruse aktualisht kontrollon rreth 95 % të rajonit të Luhanskut, por Moska ka luftuar për javë të tëra për ta pushtuar plotësisht atë, pavarësisht se ka vendosur trupa shtesë dhe ka një avantazh të

madh në asetet ushtarake.

Në qytetin e Severodonjeckut, një nga pikat më të nxehta të luftimeve, trupat ukrainase kanë arritur të rezistojnë në fabrikën e lëndëve kimike Azot, ku janë duke u strehuar edhe qindra civilë. Sipas guvernatorit Serhiy Haidai, forcat ruse po e shndërrojnë zonën "në rrënoja". "Është një katastrofë e vërtetë", deklaroi Haidai për AP. "Pozicionet tona po goditen vazhdimisht me mortaja, raketahedhës të shumtë, artileri të kalibrin të madh, sulme me raketa", njoftoi Haidai.

Mbrojtja e fabrikës kimike solli në mendje betejën për fabrikën e rrethuar të çelikut Azovstal në qytetin e pushtuar të Mariupolit, ku trupat ukrainase ishin ngujuar për javë të tëra.

Lysychansku, i vetmi qytet në rajonin e Luhanskut që është ende plotësisht nën kontrollin e



Ukrainës, është gjithashtu objektivi i sulmeve të shumta ajrore.

Zyra e presidentit të Ukrainës bëri me dije të martën se të paktën gjashtë civilë ishin vrarë në 24 orët e fundit dhe 16 të tjerë ishin plagosur.

Sipas përditësimit të fundit, forcat ruse bombarduan gjatë ditës edhe rajonin verior Chernihiv dhe dytë më të madh të Ukrainës, atë të Harkivitit. Shpërthime u dëgjuan edhe në qytetin jugor të Mikolaivit.

Sulmet ajrore në Severodonjeck dhe Lysychansk kanë shkatërruar më shumë se dhjetë ndërtesa banimi dhe një stacion policie. Në qytetin Avdiivka në rajonin e Donjeckut, një shkollë u dogji si rezultat i bombardimeve, njoftoi zyra e presidentit.

## Ben Stiller i thotë Zelenskyt: Ju jeni heroi im



**KIEV, 21 QERSHOR** - Aktori i Hollivudit dhe ambasadori i vullnetit të mirë i Kombeve të Bashkuara, Ben Stiller, e ka konsideruar presidentin ukrainas Volodymyr Zelensky hero gjatë një vizite në Kiev. "Ajo çfarë keni bërë, mënyra si e keni mobilizuar shtetin, botën, është vërtet inspiruese", ka thënë ylli amerikan 56-vjeçar, duke iu referuar fjalimeve të Zelenskyt para parlamenteve në gjithë botën.

"Është nder i madh për mua... ju jeni heroi im", ka thënë Stiller, i cili është emëruar ambasador i

vullnetit të mirë i OKB-së më 2018.

Vizita e tij në Kiev dhe takimi me Zelenskyt janë realizuar në Ditën Botërore të Refugjatëve.

Zelensky dhe Stiller kanë diskutuar për nevojat e personave të zhvendosur përkohësisht në Poloni, të cilët Stiller i ka vizituar para se ta takonte Zelenskyt.

Gjatë vizitës së tij, Stiller ka vizituar edhe lagjet e Irpinit, ku janë zhvilluar luftime të ashpra në ditët e para të luftës. "Mendoj se është e vështirë të kuptosh se çfarë po ndodh këtu, nëse nuk

keni qenë personalisht në këto ambiente", i ka thënë ai Zelenskyt. Të dy kanë folur edhe për karrierat që kanë pasur si aktorë komedianë. "Ju keni hequr dorë nga një karrierë e mrekullueshme aktrimi", i ka thënë Stiller, Zelenskyt.

"Jo aq të mirë sa e juaja", i është përgjigjur Zelenskyt.

Para fitores në zgjedhjet presidenciale më 2019, Zelensky është njohur më së miri për rolin që ka pasur në një serial televiziv, ku ka luajtur rolin e një mësuesi në një shkollë të mesme.

## Putin: Raketa interkontinentale 'Sarmat' do të jetë funksionale në fund të vitit

**MOSKË, 21 QERSHOR** - Presidenti rus Vladimir Putin u shpreh "krenar" për aksionet e kryera nga ushtarët e tij në Ukrainë, në atë që Kremli e quan "operacion special ushtarak". "Jemi krenarë që gjatë operacionit special ushtarak luftëtarët tanë veprojnë me kurajë, profesionalizëm dhe si heronj të vërtetë", u shpreh Putini gjatë një takimi me studentët e Akademisë Ushtarake, i cili u transmetua në televizionin shtetëror rus.

Duke iu referuar sanksioneve të vendosura nga Perëndimi, pas ndërhyrjes në Ukrainë, ai tha se "ato do të tejkaloheshin".

Dhe "në kohën kur duhet të përballemi me kërcënime dhe rreze të reja, ne do të vazhdojmë t'i zhvillojmë dhe forcojmë forcat tona të armatosura", tha ai, duke

premtuar se raketa e re interkontinentale "Sarmat" do të jetë funksionale në fund të vitit "Nuk ka asnjë dyshim se do të jemi më të fortë", shtoi Putini.

Raketa balistike "Sarmat" u testua në prill. Kjo armë, sipas Ministrisë së Mbrojtjes të Rusisë, është e aftë të "depërtojë në çdo sistem të mbrojtjes raketore ekzistuese ose të së ardhmes" dhe vetë Putini kishte njoftuar se do t'i japë garanci sigurie Rusisë "kundër kërcënimeve aktuale" dhe "do t'i bëjë të reflektojnë ata që bëjnë komente kërcënuese".

Më 24 shkurt Putini dërgoi trupat ushtarake në Ukrainën fqinje për "ta çmilitarizuar" dhe "denazifikuar" vendin. Putini ka thënë shpeshherë se ekonomia ruse ia ka arritur qëllimit për t'u bërë ballë sanksioneve të paprecedentë të vendosura nga Perëndimi.



# Tre kompromise që mund t'i kërkohen Kosovës



Milazim KRASNIQI

Në fazën finale të dialogut ndërmjet Kosovës e Serbisë dhe në termat e një marrëveshje obliguese eventuale, vendit tonë mund t'i kërkohet të bëjë kompromis edhe në këto tri çështje.

E para, kompromisi i ri i Kosovës mund të jetë heqja dorë nga padia kundër Serbisë për gjenocid. Natyrisht do të ishte një kompromis i dhimbshëm dhe i padrejtë, por ka mundësi që do të imponohet nga faktorët ndërkombëtarë në pakon e marrëveshjes finale obliguese ndërmjet Kosovës e Serbisë, me të cilën mund të shpallet e mbyllur edhe armiqësia shekullore. Në fakt, kompromisi në këtë çështje do të ishte shumë i padrejtë, pasi që dihet se padia për gjenocid kundër Serbisë ka bazë të fortë politike dhe juridike. Serbia është bombarduar nga NATO-ja për t'i ndaluar krimet e ushtrisë dhe të policisë së Serbisë kundër popullit shqiptar të Kosovës, për ta ndaluar spastrimin etnik. Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit është miratuar për ta ndaluar katastrofën humanitare, një shprehje që esencialisht mbulon krimin e gjenocidit. Sekretari i OKB-së i asaj kohe, Kofi Anani, veprimet e atëhershme të soldateskës serbe i pati quajtur

taktika të tokës së djegur. Po ashtu, dihet se zyrtarët më të lartë shtetërorë të Serbisë të asaj kohe, me vendime finale të Tribunalit të Hagës, janë shpallur faktorë dhe janë dënua për krimet që ushtria dhe policia e Serbisë kanë kryer kundër civilëve shqiptarë në Kosovë. Pra, në bazë të këtyre tre fakteve, Kosova e ka të hapur rrugën që ta paditë Serbisë për gjenocidin që ka kryer kundër popullit shqiptar në Kosovë. Rrjedhimisht heqja dorë e Kosovës nga padia kundër Serbisë për gjenocid do të ishte kompromis i rëndë dhe i padrejtë, pasi që krimi serb i gjenocidit është qartësisht i vërtetueshëm. Por, komuniteti ndërkombëtar nuk është në favor të një padie të tillë tash e njëzet vjet dhe me siguri do të mbetet në të njëjta pozita. (Përveç nëse detyrohet ta aktivizojë si mjet presioni ndaj kokëfortësisë së Qeverisë së Serbisë në negociatë.) Komuniteti ndërkombëtar një padi të tillë e sheh si pengesë drejt një marrëveshjeje dhe një pajtim ndërmjet Kosovës e Serbisë në të ardhmen. Bile ka gjasa që për ta penguar një padi të tillë është ngritur Gjykata Speciale. (Nuk e di a është rastësi që dy figurat politike shqiptare, që e kanë përmendur më së shpeshti

mundësinë e padisë për gjenocid kundër Serbisë, Hashim Thaçi e Kadri Veseli, ndonëse pa veprime konkrete edhe ata, janë të parët që janë sulmuar nga padia e prokurorit special të Gjykatës Speciale).

Kompromisi i dytë i rëndë që mund të detyrohet të bëjë Kosova në një marrëveshje eventuale gjithëpërfshirëse obliguese me Serbinë është formimi i bashkësisë së komunave serbe me ingerenca de fakto ekzekutive. Ato ingerenca nuk do të shpallen si ekzekutive, por gjasat janë se do të jenë të atilla. Pra, në letër, bashkësia e komunave serbe mund të mos ketë karakter bllokues ndaj shtetit, por në terren do të jetë pikërisht me karakter bllokues, nga interpretimi që do t'ia bëjnë serbët lokalë, të nxitur nga Serbia e Rusia, për ta mbajtur aktiv destabilizimin e Kosovës. Vetë fakti që ajo bashkësi komunash do të ketë parashenjë etnike, do të japë mundësi të interpretohet si entitet serb.

Kompromisi i tretë mund të jetë bashkëpunimi ekonomik, me të cilin do të konceptohej Kosova si sferë e ndikimit dhe dominimit ekonomik të Serbisë, si apendiks i hapësirës ekonomike dhe tregut serb. Kjo mund t'i atakojë Trepçën dhe Gazivodën, por në pako me to

ka rrezik ta përfshijë edhe KEK-un, mbase edhe tërë ekonominë e vendit tonë. Në rrethanat e një ekonomie të tregut të lirë, një kompromis i tillë do të ishte absurd dhe me kohë do të shndërrohej në burim të ri të konfliktit. Prandaj, sado që të bëhet presion në këtë çështje, Kosova nuk duhet të pranojë kompromise që ia imponojnë inferioritetin në sferën e bashkëpunimit ekonomik me Serbinë. Në fund të fundit, mjetet e Bashkimit Evropian për presion mbi Kosovën janë të pakta, pasi që shumica e shteteve të BE-së e kanë njohur Kosovën. Ato shtete nuk mund të heqin dorë nga njohja, sepse në atë rast do të kontribuonin për ndezjen e konfliktit në oborrin e vet.

Si mund të shmanget gjithë ky rrezik për këso kompromisesh të rënda? Qeveria e Kosovës duhet ta rikthejë vëmendjen te kompromiset e mëdha dhe të rënda që ka bërë Kosova në Procesin e Vjenës. Në Planin Gjithëpërfshirës të Marti Ahtisarit janë inkorporuar të gjitha ato kompromise me synimin që të arrihet njohja e Kosovës nga Serbia dhe të hapet rruga e anëtarësimit të Kosovës në OKB, meqë Ahtisari ishte emisar i sekretarit të përgjithshëm të OKB-

së. Edhe pse Kosova i pranoi të gjitha ato kompromise, Serbia nuk e pranoi Planin, me çka u bllokua edhe anëtarësimi i Kosovës në OKB dhe në organizata të tjera. Por, Serbia i shfrytëzoi favoret e kompromiseve të Planit Ahtisari dhe i shfrytëzoi maksimalisht edhe sot. Ndërhyrjet e shumta brutale të Serbisë në Kosovë janë arsyetuar e arsyetohen edhe sot me provizionet e Planit të Ahtisarit. Ndërsa Serbia deri sot nuk e ka bërë asnjë kompromis, pasi që edhe në Kushtetutë e ka mbajtur formulimin e vjetër për Kosovën. Ndërsa Kosova ka bërë kompromise deri dhe absurde, siç është ndalimi i përdorimit të disa ngjyrave në simbolet e veta shtetërore. Rrjedhimisht, tash kompromiset duhet të kërkohen nga pala që deri sot nuk ka bërë asnjë kompromis, paçka se është palë që e ka humbur luftën, për çka është dëshmi Marrëveshja Tekniko-Ushtarake e Kumanovës. Askund palës humbëse nuk i bëhen favore. Prandaj tentimi eventuale, i kujtdoqoftë, për ta detyruar Kosovën për kompromise të reja e të rënda, do të ishte dënim për viktimën dhe shpërblim për agresorin. Do të ishte një rikthim në stepën e barbarisë.

## Osmani: Komunitetet janë vlerë e shtuar e shoqërisë sonë

PRISHTINË, 21 QERSHOR (ER)-Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, në prag të 24 qershorit, ditës nacionale të komunitetit egjiptian, ka pritur një grup të grave të këtij komuniteti. Osmani ka theksuar se është fat i Kosovës që përbëhet nga një shoqëri diverse, pjesë e së


cilës janë edhe vajzat dhe gratë egjiptiane, të cilat angazhohen aktivisht në avancimin e të drejtave të komunitetit. "Komunitetet janë vlerë e shtuar e shoqërisë sonë, dhe duhet të bëjmë çmos që t'u garantojmë mundësi dhe trajtim të barabartë. Fuqizimi i gruas

është prioritet për mua. Ofrimi i mundësive për punësim krijon jo vetëm pavarësi ekonomike, duke pasur parasysh faktin se roli i grave në shoqëri është i jashtëzakonshëm, në të gjitha fushat", ka theksuar Osmani. Në takim, presidentja ka inkurajuar vajzat dhe gratë e

komunitetit egjiptian që ta vazhdojnë angazhimin për fuqizimin e tyre. "Si institucione të vendit, do të kujdesemi për qasje gjithëpërfshirëse dhe garantim të të drejtave tuaja. Përkrahja dhe fuqizimi i grave duhet të jetë angazhim i përbashkët në mënyrë që çdo



qytetar të trajtohet me dinjitet dhe të jetë i barabartë", ka thënë Osmani në takim me vajza e gra të komunitetit egjiptian.



Kosova dhe Serbia arrijnë marrëveshje për energjinë

# Pa e ndryshuar asnjë presje, qeveria Kurti finalizoi marrëveshjen e Thaçit dhe të Mustafës për energjinë

Delegacioni i Kosovës dhe ai i Serbisë kanë arritur të martën pajtueshmëri për zbatimin e marrëveshjes ekzistuese për energjinë. Takimet janë zhvilluar në Bruksel në kuadër të dialogut për normalizim të marrëdhënieve mes dy shteteve i cili ka nisur më 2011. I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për këtë dialog, Mirosllav Lajçak, marrëveshjen e arritur e ka quajtur “hap të madh”. Ndërkaq opozita ka theksuar se kryeministri Kurti qenka pajtuar për planin e zbatimit të marrëveshjes për energji të hartuar në Bruksel më 2015. “Po të njëjtën marrëveshje kryeministri atëbotë e konsideronte tradhti kombëtare”, ka thënë nënkryetarja e PDK-së, Vlora Çitaku

**EPOKA  
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHINË, 21 QERSHOR - Kosova dhe Serbia kanë arritur të martën marrëveshje për energjinë. Lajmin e ka bërë me dije emisari i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Mirosllav Lajçak. “Me kënaqësi njoftoj se Kosova dhe Serbia kanë miratuar Udhërrëfyesin për Zbatimin e Marrëveshjeve të Energjisë në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE-ja. Ky është një hap i madh përpara”, ka shkruar Lajçaku në

“Twitter”.

Për arritjen e kësaj marrëveshjeje ka njoftuar edhe kryenegociatori i Kosovës në dialogun me Serbinë, Besnik Bislimi. “Kjo mundëson faturimin e energjisë elektrike në katër komunat veriore të Kosovës, sipas ligjeve dhe sistemit rregullativ të Kosovës”, ka shkruar Bislimi në llogarinë e vet “Twitter” pas takimit ndërmjet palëve nga Kosova dhe Serbia në kuadër të dialogut të lehtësuar nga Bashkimi Evropian. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është deklaruar lidhur me arritjen e

marrëveshjes mes Kosovës e Serbisë për faturimin e energjisë në veri. Arritjen e kësaj marrëveshjeje Kurti e ka quajtur lajm të mirë dhe tha se është rezultat i punës së qeverisë që ai udhëheqë.

Ai ka thënë se së shpejti do të fillojë faturimi i rrymës për komunat në veri. I pyetur se a është marrëveshje që e kanë kritikuar si Lëvizje Vetëvendosje, Kurti tha se një situatë e tillë është trashëguar nga të tjerët. “Por është mirë që do të fillojë inkasimi i energjisë në veri sepse i

është shkaktuar dëm i madh Kosovës”, ka thënë Kurti Ndërkaq kryenegociatori serb Petar Petković e ka interpretuar ndryshe marrëveshjen në Bruksel për energjinë në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Shefi i së ashtuquajturës “Zyra për Kosovën” në Serbi thotë se kompania serbe ‘Elektrosever’ ka fituar pavarësi në furnizimin me rrymë në katër komunat veriore. “Elektrosever do të kryejë edhe shërbime të rëndësishme të shpërndarjes, pra ajo që kemi kërkuar dhe në të cilën kemi insistuar. Elektrosever do të kryejë shërbime të shpërndarjes, si: faturim, pagesa, mirëmbajtje të rrjetit dhe lidhje fizike të konsumatorëve. Kjo është shumë e rëndësishme, sepse do të thotë se kemi autonomi në furnizimin e veriut të ‘Kosovës dhe Metohisë’ me energji elektrike”, ka deklaruar Petković. Ai ka theksuar se pas kësaj

marrëveshjeje është hapur rruga edhe për bisedime për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë.

Qytetarët e komunave në veri, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok, kryesisht me shumicë serbe, nuk kanë paguar rrymën e shpenzuar që nga viti 1999. Ndërkaq opozita ka drejtuar kritika në adresë të qeverisë Kurti për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Nënkryetarja e PDK-së, Vlora Çitaku, ka thënë se kryeministri Kurti qenka pajtuar për planin e zbatimit të marrëveshjes për energji të pajtuar në Bruksel më 2015. “Pa i hequr asnjë pikë e asnjë presje, kryeministri Kurti qenka dakorduar për planin e zbatimit të marrëveshjes për energji të dakorduar në Bruksel më 2015. Po të njëjtën marrëveshje kryeministri atëbotë e konsideronte tradhti kombëtare. E vetmja gjë konsistente te Kurti është mungesa e

konsistencës. Kryeministri ua ka borxh votuesve të tij një sqarim, a e ka pasur gabim atëherë, apo e ka gabim tash? Kryeministri është shndërruar në noter të marrëveshjeve paraprake, duke e kthyer procesin mbrapa e duke humbur kohë”, ka thënë Çitaku.

Edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka reaguar për marrëveshjen e arritur për energjinë. Ai ka thënë se e tëra që thuhet në këtë marrëveshje bazohet në marrëveshjet e mëparshme për energjinë 2013/2015, veçse këtu janë dhënë edhe afatet kohore. “Nëse pala serbe e zbaton këtë ‘roadmap’ nuk është keq në krahasim me gjendjen e tanishme. Pra e tëra, siç po thuhet në këtë marrëveshje, bazohet në marrëveshjet e mëparshme për energjinë të viteve 2013/2015, veçse këtu janë vënë edhe afatet kohore”, ka deklaruar Haradinaj.

Kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj, ish-bashkëpunëtor i Kurtit, ka thënë se marrëveshja e arritur për energjinë është avancim i autonomisë së veriut. “Udhërrëfyesi për energjinë na tregoi udhën që ky dialog po e ndjek. Koordinatat e një marrëveshjeje përfundimtare tashmë kanë dalë në sipërfaqe. Nuk la vend për hamendje e spekulime. As për interpretime. Ajo çka dihet është që asnjë marrëveshje që ka në qendër paqen mes popujve nuk lejon krijimin e entiteteve autonome në hapësirën shtetërore të një vendi

## Ambasada e Francës dhe Gjermanisë për marrëveshjen për energjinë: Lajm shumë i mirë

Ambasada e Francës në Kosovë ka reaguar pas arritjes së Marrëveshjes për Energjinë ndërmjet vendit tonë dhe Serbisë. Sipas tyre, ky dokument paraqet një përparim në dialog dhe se duhet të sigurohet zbatimi i plotë i marrëveshjes. “Franca mirëpret udhërrëfyesin e miratuar sot në Bruksel ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, dokument ky që paraqet përparim konkret dhe domethënës në dialog. Tani e tutje duhet siguruar zbatimin e plotë të tij”, thuhet në reagimin e Ambasadës së Francës në Kosovë. Edhe ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, ka reaguar pas arritjes së marrëveshjes për energjinë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. “Vërtet një lajm shumë i mirë! Përgëzime për palët pjesëmarrëse dhe veçanërisht për Miroslav Lajçak për përpjekjet e tij të vazhdueshme për të ofruar kompromis. Ajo që nevojitet tani është zbatimi i shpejtë siç parashikohet në udhërrëfyes”, ka theksuar Rohde.



tjetër. Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe e ka thelbin te kjo natyrë politike. Përjetësimi i konfliktit është ushqim për politikanët autoritarë si Kurti e Vuçiqi”, ka shkruar Molliqaj në

“Facebook”.

Molliqaj ka theksuar se edhe më herët e kanë bërë të qartë se Kurti është vazhdimësi e marrëveshjeve të pjesshme të cilat vizatojnë hartën e Kosovës mbi baza etnike. “Përmes kësaj marrëveshjeje Kurti po institucionalizon statusin e veçantë të komunave veriore të Kosovës. Ai po kujdeset që marrëveshjet që dikur mbeten vetëm tekste pa fuqi politike, të marrin jetë. Përdërisa procesi i kaluar negociator e kishte si qasje politike arritjen e marrëveshjeve përmes pjesëve të ndryshme, procesi i tanishëm në krye me Kurtin ka si strategji këtë qasje: marrëveshjet për tema të veçanta si arritje më e lehtë dhe disi e padallueshme e perfide e marrëveshjes finale, pa u dalluar efektet aty për aty. Ky është

popullizmi. Ky është rreziku”, ka deklaruar lideri i PSD-së, duke shtuar se pushtetit të ri iu dashtë pak kohë për ta rrezuar tërë ligjërimin e ndërtuar pikërisht ndaj kësaj qasjeje dhe kësaj përmbajtjeje që u firmos. “Nënshkrimi i Qeverisë së Kosovës nuk na përfaqëson”, ka thënë Molliqaj.

Analisti Fadil Hoxha ka reaguar pas miratimit të udhërrëfyesit për zbatimin e Marrëveshjeve të energjisë në kuadër të dialogut të Brukselit. Ai në llogarinë e vet në “Facebook” ka theksuar se marrëveshja për energjinë, ndërmjet Kosovës e Serbisë, në fakt është dokument implementues i marrëveshjeve të mëhershme. “Këtë marrëveshje duhet përshëndetur plotësisht sepse Serbia e njeh sovranitetin e

Kosovës në tërë territorin e saj në aspektin energjetik. Pra, duke përfshirë edhe veriun problematik. Aspektet e tjera pozitive të marrëveshjes: Nuk ka më pagesë për rrymë nga buxheti i Kosovës për qytetarët në veri; Institucionet e Kosovës kanë qasje të plotë në infrastrukturën energjetike në veri e sidomos asetin më problematik - trafostacionin në Vallaq; Kompanitë serbe për furnizim dhe distribucion në veri do të funksionojnë ekskluzivisht sipas ligjeve të shtetit të Kosovës dhe qeveria Kurti e kupton se krejt propaganda e bërë ndaj këtyre marrëveshjeve ishte një propagandë dhe mashtrim i qytetarëve dhe për këtë duhet të paguajë një çmim në zgjedhjet e ardhshme”, ka thënë Hoxha.



### Energy Agreements' Implementation Roadmap

In order to overcome the crisis and problems in energy sector, whereas taking note of the Arrangements regarding Energy of 8 September 2013 (“2013 Energy Agreement”), and the Conclusions of the EU facilitator on the implementation of the 2013 Energy Agreement of 25 August 2015 (“2015 Energy Agreement”), the parties have agreed to the following Roadmap:

1. ERO will issue a supply license to Elektroserb. ERO will ensure compliance with the conditions set forth by the supply license, in accordance with Kosovo legal and regulatory framework.
2. Within seven days of issuance of a supply license, Elektroserb will provide to KEDS and KOSTT the most recent data available on consumers, via the EU.
3. Within 10 days of issuance of a supply license, Elektroserb will sign the necessary technical agreements with KOSTT and KEDS in order to operate in the Kosovo's energy market, i.e., the Framework Agreement on acceptance of Electricity market rules with KOSTT, the Agreement on Balance Liability with KOSTT, the Connection Agreement with KEDS, and a commercial agreement with KEDS to provide distribution services (billing, collection, maintenance and physical connection of new customers) in the four northern Serb majority municipalities, as per paragraph 1 of art. 5 of the 2013 Agreement.
4. Within 15 days of signing the necessary technical agreements with KOSTT, Elektroserb will obtain an Energy Identification Code (EIC) in order to perform activities foreseen by the supply license.
5. In accordance with Art. 14 of the 2015 Energy Agreement, within 30 days of issuance of a supply license, KEDS and KOSTT (under EU facilitation, if required) will have access to Valso/Vallaq sub-station, as well as to other transmission and distribution infrastructure.
6. Within 45 days of issuance of the supply license, KOSTT and KEDS, upon consulting with Elektroserb, will submit to ERO the investment plan and maintenance costs required and network losses, based on thorough consideration of the existing infrastructure.
7. Within 21 days after the submission of investment plan and maintenance costs required and network losses, ERO will approve in principle these plans, costs and losses.
8. In case of non-compliance with the provisions of these Agreed Conclusions after 100 days of the issuance of the supply license, ERO may decide to suspend and/or withdraw the supply license granted to Elektroserb, subject to prior consultation between the parties, facilitated by the EU, during a maximum period of 15 days. The EU will provide an expert opinion.



## GIZI gjerman i jep Podujevës kamion për grumbullimin e mbeturinave

PODUJEVË, 21 QERSHOR - (ER) Të martën Njësia Operative "Pastrimi" në Podujevë ka pranuar donacion nga GIZI gjerman një kamion për grumbullimin e

mbeturinave. Në ceremoninë e pranimit të këtij donacioni ishte i pranishëm drejtori i Shërbimeve Publike në Podujevë, Bahri Selimi.

Në këtë ceremoni të pranim-dorëzimit të donacioneve me kamionë për komuna të Kosovës ishin edhe ministrat Liburn Aliu, Artanë Rizvanolli dhe Elbert Krasniqi.

I pranishëm në këtë ceremoni ishte edhe ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, kryetarë komunash dhe përfaqësues të komunave.



## Sadiku: Fshatrat kanë treguar interesim më të madh për pjesëmarrje në dëgjimet buxhetore

GJILAN, 21 QERSHOR (ER) - Ciklin e dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2023-2025 komuna e Gjilanit e ka përmbyllur të martën me një takim kryesor i cili është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal.

Arianit Sadiku, kryesues i Kuvendit, ka thënë se gjatë javës janë mbajtur pesë dëgjime buxhetore nëpër lokalitete dhe interesimi i qytetarëve për të marrë pjesë dhe për t'i paraqitur kërkesat e tyre ka qenë i kënaqshëm, veçmas në fshatra.

Riad Rashiti, drejtor për Buxhet e Financa, i cili e ka paraqitur KAB-in, ka thënë se gjatë viteve 2023-2025 buxheti komunal do të shënojë rritje nga viti në vit. Buxheti i planifikuar për vitin



2023 do të jetë 32 milionë e 599 mijë euro, ose për 3.5 milionë më i madh se buxheti i këtij viti, kurse investimet kapitale shënojnë rritje për 1.7 milion euro.

Për vitin 2024 buxheti i planifikuar do të jetë 34 milionë e 730 mijë euro, kurse për vitin 2025 mbi 36 milionë euro.

Të hyrat vetjake komunale do të shënojnë rritje graduale: nga

4.9 milionë në vitin 2023, në 5.1 milionë në vitin 2024, përkatësisht 5.3 milionë në vitin 2025, ka thënë Rashiti, i cili ka dhënë edhe hollësi për tendencat buxhetore për tri

vitet e ardhshme.

Me pyetje, propozime dhe kërkesa konkrete për investime në lokalitetet ku ata jetojnë, janë përfshirë në debat dhjetëra qytetarë të pranishëm, si Avni Shkodra, Izer Zeqiri, Rexhep Sejdiu, Lirim Rashiti, Mursel Zymberi, Fadil Abazi, Ruzhdi Selimi, Shyqeri Salihu, Ramadan Mehmeti e të tjerë.

Kryesuesi i Kuvendit, Arianit Sadiku, ka thënë se disa prej kërkesave të parashtruara, siç është ajo për vazhdimin e sheshit në pjesën veriore, rrugët dhe të tjera, janë në proces të fillimit të punimeve. Riad Rashiti (DBF) tha se kërkesat do të merren parasysh dhe do të realizohen si prioritete brenda mundësive buxhetore.

## Komuna e Kamenicës nënshkruan marrëveshje me 'Dardanapress' për ngritjen e transparencës komunale

KAMENICË, 21 QERSHOR (ER) - Kryetari i komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj, së bashku me kryesuesin e Kuvendit Komunal, Liridon Kastrati, kanë pritur në takim drejtorin ekzekutiv të OJQ "Dardanapress", Sherafedin Vranja.

Në këtë takim është nënshkruar marrëveshja e mirëkuptimit në mes të komunës së Kamenicës dhe OJQ "Dardanapress", e cila është nënshkruar në kuadër të projektit "Ngritja e transparencës komunale dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje".

Rahimaj ka thënë se komuna e Kamenicës është gjithmonë e gatshme sa i përket përkrahjes së punës në këtë projekt duke e marrë parasysh se kjo është në të mirë të vetë komunës.

Ndërsa projektmenaxheri Sherafedin Vranja, duke i



njoftuar krerët institucionalë të komunës së Kamenicës lidhur me realizimin dhe

implementimin e aktiviteteve të parapara në projekt, ka thënë se qëllimi i

përgjithshëm i projektit është ngritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve të komunës së

Kamenicës, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve, grupeve të marginalizuara, përmes qasjes aktive në proceset vendimmarrëse dhe për ngritjen e transparencës në qeverisjen lokale.

Kurse kryesuesi i Kuvendit, Liridon Kastrati, është shprehur se edhe Kuvendi Komunal i Kamenicës është i gatshëm t'i zbatojë të gjitha pikat e marrëveshjes, duke përfshirë Kuvendin edhe organet e tij, si dhe nuk do të mungojë përkrahja e kryesuesit dhe anëtarëve të Kuvendit për ta realizuar këtë projekt.

Ky projekt është financuar nga programi i KCSF-së për mbështetje të shoqërisë civile "EJA Kosovë", bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) Suedia dhe Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut.

## Në Ferizaj realizohen 73 urdhëresa të gjykatave për vepra penale

PRISHTINË, 21 QERSHOR (ER) - Drejtoria Rajonale e Policisë në Ferizaj ka vazhduar aktivitetet sipas planit për t'i realizuar urdhëresat e

Gjykatës Themelore. Gjatë javës së kaluar, nga data 13 deri më 19 qershor 2022, janë realizuar 73 urdhëresa të gjykatave

kompetente për vepra të ndryshme penale dhe kundërvajtëse.

Drejtoria Rajonale e Policisë në Ferizaj ka njoftuar se do

ta vazhdojë realizimin e urdhëresave ndaj personave që ende nuk u janë përgjigjur thirrjeve të gjykatave.



## PDK - AAK: Tërheqja e parave nga Trusti, e domosdoshme për qytetarët

EPOKA  
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Sot (e mërkurë) është caktuar seanca për ndryshimin e Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës përmes të cilit mundësohet tërheqja e 30 për qind të mjeteve nga Trusti. Kjo iniciativë vjen nga opozita, konkretisht nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), mbështetur ndërkohë edhe nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Abelard Tahiri, ka thënë se në mungesë të alternativave nga qeveria dhe përballë gjendjes së rënduar sociale, tërheqja e një pjese të parave të Trustit është një masë e domosdoshme për ta lehtësuar



ballafaqimin e qytetarëve me këtë gjendje. "Mundësia për të tërhequr një pjesë nga paratë e kursyera në këto rrethana, ka qenë kërkesë e drejtpërdrejtë e

qytetarëve, prandaj i ftoj të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës, veçmas ata të mazhorancës, që nesër ta votojnë projektligjin që mundëson një gjë të tillë. Kjo nuk

është betejë politike, por domosdoshmëri konkrete dhe kërkesë e të gjithë qytetarëve pa dallim.

Edhe shefi i grupit parlamentar i

AAK-së, Besnik Tahiri, ka theksuar se situata në Kosovë, në aspektin social, kurrë nuk ka qenë më e vështirë. Ai shpreson se vota e deputetëve do të jetë pro tërheqjes së mjeteve nga Trusti. "Situata në Kosovë, në aspektin social, kurrë nuk ka qenë më e vështirë! Çmimet janë ngritur shumë, pagat kanë mbetur të njëjta, përderisa ndihma e shtetit është më se minimale. Kuvendi i Kosovës, në veçanti shumica parlamentare, e ka në dorë që nesër ta miratojë në lexim të parë Ligjin për Trustin, i cili sadopak do t'i zbuste vështirësitë për njerëzit në nevojë, kontributdhënësit në një situatë krize. Mos të filozofojmë shumë, por të veprohet me votën për. Shpresoj që vota e mazhorancës do të jetë për këtë ligj", ka shkruar Tahiri në "Facebook".

## Konjufca: AShAK-u, bartëse e procesit të shtetndërtimit

PRISHTINË, 21 QERSHOR (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, i shoqëruar nga kryetari i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport, Ardian Gola, si dhe shefi i Kabinetit, Ilir Kërçeli, vizituan Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës (AShAK), me ç'rast u pritën nga kryetari, akademik Mehmet Kraja dhe kryesia e këtij institucioni.

Konjufca vlerësoi lart rolin e AShAK-ut në proceset nëpër të cilat ka kaluar Kosova si dhe kontributin e saj në shtetndërtimin e Kosovës. "Para se ta kemi shtetin, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës ka qenë bartëse e procesit të shtetndërtimit, institucion ky i përbërë nga figurat më eminente, intelektualë të shquar, të cilët kanë dhënë



kontribut të jashtëzakonshëm. Akademitë janë ato të cilat i hetojnë sfidat dhe më pas japin objektivat e

tyre se si të zgjidhen këto sfida në shtet, por edhe në shoqëri. I tillë ka qenë edhe roli i Akademisë së Shkencave dhe

Arteve të Kosovës", ka theksuar Konjufca.

Ndër të tjera, ai ka thënë se Kuvendi ka gatishmërinë për

të qenë sa më afër AShAK-ut dhe për të punuar si dy institucione për proceset e rëndësishme të vendit.

Kryetari i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport, Ardian Gola, shtroi nevojën e ngritjes së një debati të gjerë, në mënyrë që punimet shkencore të studiuesve të shkencave albanologjike të njihen si të vlefshme për avancime akademike.

Ndërkaq, akademik Mehmet Kraja, pasi falënderoi kryetarin Konjufca për vizitën dhe për ofrimin e gatishmërisë për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve, foli për projektet, konferencat dhe botimet e AShAK-ut. Po ashtu, akademik Kraja theksoi se, krahas projekteve, po punohet edhe për avancimin e rolit të AShAK-ut.

## Lehtësohen procedurat për regjistrim të studentëve ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë

PRISHTINË, 21 QERSHOR (ER) - Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për mbledhjen e përbashkët të dy qeverive për lehtësimin e procedurave të pranimit të studentëve në institucionet e arsimit të lartë në të dy vendet.

Me këtë marrëveshje hiqen të gjitha kufizimet për pranimin e studentëve në institucionet

publike të arsimit të lartë në dy vendet tona dhe ofrohen mundësi të barabarta për të gjithë të rinjtë shqiptarë nga Kosova dhe Shqipëria që të aplikojnë në 19 universitetet publike të vendeve tona.

Përveç që rriten mundësitë për përzgjedhje të institucionit dhe programit të studimeve, sipas marrëveshjes, të rinjtë tanë do të mund ta shfrytëzojnë këtë mundësi që nga ky vit akademik, pasi që u nënshkrua në prag të afateve për regjistrim në institucionet e arsimit të

lartë.

Bashkëpunimi i përcaktuar me këtë marrëveshje do të zbatohet në pajtim me legjislacionin në fuqi të të dy vendeve si dhe, sipas parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të njohjes së diplomave, përcaktuar në dokumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, anëtare të të cilave janë të dy ministrtritë.

Në emër të MASHTI-t marrëveshja është nënshkruar nga zëvendësministri i Arsimit, Dukagjin Pupovci.



# Mirëpritet një hetim parlamentar për gjendjen në të cilën menaxhmentet e kaluara e kanë sjellë RTK-në

Prishtinë, 21 qershor (ER) - Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka mbajtur të martën mbledhjen e radhës, të kryesuar nga Hykmete Bajrami, kryetare. Në këtë mbledhje është shqyrtuar raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Radio Televizionit të Kosovës për vitin 2021 si dhe raporti i auditimit i performancës për menaxhimin e fondeve publike në Radio Televizionin e Kosovës.

Të ftuar për të diskutuar mbi të gjeturat e raportit të auditimit për pasqyrat financiare, si dhe për menaxhimin e fondeve publike të Radio Televizionit të Kosovës, ishin përfaqësues të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) si dhe anëtarë të Bordit të RTK-së.

Lidhur me raportin e auditimit të performancës për menaxhimin e fondeve publike të RTK-së, deputeti raportues, Eman Rrahmani, para anëtarëve të këtij komisioni dhe përfaqësuesve të të dyja institucioneve, ka paraqitur një pasqyrë të

shkurtër të raportit. Ai ka përmendur disa prej rekomandimeve më të zëshme të ZKA-së, të cilat, sipas tij, kërkojnë trajtim dhe përforsim të menjëhershëm në mënyrë që RTK-së t'i kthehet funksionimi i mirëfilltë.

Ndërsa kryesuesi i Bordit të RTK-së, Besnik Boletini, ka thënë se shumica prej rekomandimeve tashmë janë adresuar, duke premtuar se gjatë këtij viti do të zbatohen ashtu siç ka rekomanduar ZKA-ja. Ndër të tjera, ai ka theksuar se Bordi i RTK-së e mirëpret një hetim parlamentar për gjendjen në të cilën menaxhmentet e kaluara e kanë sjellë RTK-në.

Lidhur me çështjet e ngritura nga deputetët rreth raportit të lartcekur, është përgjigjur edhe drejtori i përgjithshëm i RTK-së, Shkumbin Ahmetxhekaj, i cili ka thënë se menaxhmenti i ri i këtij bordi ka shprehur gatishmërinë e plotë për ta vendosur RTK-në në rrugë të drejtë pavarësisht prej sfidave dhe parregullsive tashmë të bëra publike.



Ndërkaq përfaqësuesja e Zyrës Kombëtare të Auditimit, Myrvete Gashi, ka kërkuar nga bordi i RTK-së që në ditët në vijim ta dërgojnë planin e punës, nga i cili mund të shihet nëse rekomandimet e dhëna janë adresuar.

Komisioni ka vazhduar mbledhjen me raportin e

auditimit për pasqyrat financiare të Radio Televizionit të Kosovës për vitin 2021.

Deputetja raportuese e këtij raporti, Hykmete Bajrami, ka theksuar se raporti për pasqyrat financiare vjetore të RTK-së nga Zyra Kombëtare e Auditimit ka marrë opinion të kundërt dhe se pasqyrat financiare të

paraqitura nuk e tregojnë gjendjen e vërtetë financiare. Duke listuar të gjeturat kryesore të këtij raporti, deputetja Bajrami ka potencuar faktin se problemet me pasqyrat financiare të RTK-së janë probleme të shtresëzuara, vlerësuar kështu edhe sipas ZKA-së.

## Nuk kalon mocioni për shkarkim të Bordit të ZRrE-së



PRISHTINË, 21 QERSHOR - Me 6 vota kundër dhe 3 për nuk ka kaluar mocioni për shkarkimin e Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRrE).

Komisioni për Ekonomi ka shqyrtuar mocionin e dhjetë deputetëve të LDK-së për shkarkimin e Bordit të ZRrE-së pasi që, sipas tyre, nuk ka qenë transparent dhe se ka dështuar ta menaxhojë krizën energjetike. "Ne kemi paralajmëruar që do të ketë krizë energjetike, por ZRrE-ja nuk e ka pranuar këtë dhe pas dy muajsh ka vazhduar kriza energjetike. ZRrE nuk ka bashkëpunuar me ne si komision. Ajo ka bërë shkelje në mbrojtje të konsumatorit. Ka dështuar ZRrE. Kur është rritur energjia, i ka përjashtuar komunat veriore nga tarifat. Edhe Avokati i Popullit ka thënë se ka pasur diskriminim

nga ZRrE-ja", ka thënë deputetja e LDK-së, Valentina Bunjaku-Rexhepi gjatë arsyetimit të këtij mocioni.


Ndërsa Lëvizja Vetëvendosje, përmes shefes së grupit parlamentar, Mimoza Kusari-Lila, e ka kundërshtuar këtë mocion. "Të shkarkohet Bordi i ZRrE-së në këtë kohë të krizës nuk është e pranueshme", ka thënë ajo, duke cituar ligjet se në cilat raste shkarkohet Bordi. Ndërsa deputeti i AAK-së, Pal Lekaj, u shpreh se qeveria dhe ZRrE-ja kanë treguar se kanë afërsi me njëra-tjetrën. "ZRrE ka komunikuar me qeverinë, ka treguar që është afër me qeverinë, ka vepruar në mënyrë jo të barabartë me qytetarët dhe çmimet. Bashkë e kanë rënduar jetën e qytetarëve me shtrenjtimin e energjisë. Kjo është e papranueshme", ka thënë Lekaj.

## Policia parandalon një rast të kontrabandimit të mallrave

PRISHTINË, 21 QERSHOR (ER) - Policia e Kosovës, respektivisht njësi policore nga Drejtoria Rajonale e Policisë Kufitare - Lindje, në zbatim të masave për parandalimin dhe luftimin e paligjshmërisë dhe kontrabandës, kanë shtuar kontrollet taktike dhe operacionale në terren. "Me datë 21.06.2022 rreth orës 00:10, njësi e taskforcës nga

drejtoria e lartcekur, gjatë kryerjes së detyrave të rregullta dhe vëzhgimit, në prita të befasishme ka arritur të vërejë dhe përcjellë hyrjen e disa mallrave përmes rrugëve malore ilegale nga Serbia në Kosovë, me ç'rast ka arritur ta parandalojë kontrabandimin e mallrave. Si rrjedhojë, ka kapur mallra të ndryshme, pije alkooolike, mish të bluar, pjesë të automjeteve, fletore etj", ka

njoftuar Policia e Kosovës. Njësi e Policisë Kufitare ka njoftuar se me mbështetjen e Hetimeve Rajonale dhe në bashkëpunim me prokurorinë e shtetit janë duke punuar intensivisht për hetimin e rastit si dhe parandalimin e rasteve të tilla, ndërsa malli i konfiskuar i dorëzohet Doganës së Kosovës për procedura të mëtejme.





# Si rrezikon të humbasë, dhe si mund ta fitojë SHBA-ja Luftën e Re të Ftohtë



Nga Joseph E. STIGLITZ

Duket se Shtetet e Bashkuara kanë hyrë në një Luftë të Re të Ftohtë me Kinën dhe Rusinë. Por portretizimi që i bëjnë udhëheqësit amerikanë kësaj përballeje, si midis demokracisë dhe autoritarizmit, nuk është i duhuri, sidomos në një kohë kur të njëjtët liderë po përballen aktivisht me një abuzues sistematik të drejtave të njeriut siç është Arabia Saudite. Një hipokrizi e tillë, sugjeron se në rrezik janë të paktën pjesërisht hegjemonia globale, dhe jo vlerat. Për 2 dekada me radhë pas rënies së Perdes së Hekurt, SHBA-ja ishte qartazi fuqia nr.1 në botë. Por më pas erdhën luftërat e gabuara dhe katastrofike në Lindjen e Mesme, kriza financiare e vitit 2008, pabarazia në rritje, epidemia e opioideve, dhe kriza të tjera që u duk se u vunë në dyshim epërsinë e modelit ekonomik të Amerikës.

Për më tepër, nga zgjedhja president e Donald Trump, përpjekja për grusht shteti në Capitol Hill, masakrave të shumta me armë, një Partie Republikane të prirur t'u heqë të drejtën e votës shumë qytetarëve, dhe forcimit së organizatave konspirative si QAnon, ka shumë prova që sugjerojnë se disa aspekte të politikës amerikane dhe jetës sociale, janë bërë tejet patologjike.

Sigurisht, Amerika nuk dëshiron të rrëzohet nga fronit. Por është thjesht e pashmangshme që Kina do ta tejkalojë ekonomikisht SHBA-në. Popullsia e saj është 4 herë

më e madhe se ajo e Amerikës; ndërsa ekonomia e saj është rritur 3 herë më shpejt për shumë vite (në fakt, ajo ia ka kaluar tashmë që në vitin 2015 SHBA-në, së aspektin e barazisë së fuqisë blerëse).

Ndërsa Kina nuk ka bërë asgjë për ta shpallur veten si një kërcënim strategjik për Amerikën, në Uashington, ekziston një konsensus dypartiak se Kina mund të përbëjë një kërcënim strategjik. Ndaj më e pakta që duhet të bëjë SHBA-ja për të zbutur rrezikun, është të ndalojë së ndihmuari rritjen e ekonomisë kineze.

Sipas këtij këndvështrimi, veprimi parandalues është i garantuar, edhe nëse kjo nënkupton shkeljen e rregullave të Organizatës Botërore të Tregtisë, për të cilat vetë SHBA-ja bëri kaq shumë për t'i shkruar dhe promovuar. Ky front në Luftën e Re të Ftohtë, u hap shumë kohë më përpara sesa Rusia të pushtonte Ukrainën.

Dhe zyrtarë të lartë amerikanë, kanë paralajmëruar që atëherë, se kjo luftë nuk duhet talargojë vëmendjen nga kërcënimet real afatgjatë: Kina. Duke pasur parasysh faktin se ekonomia e Rusisë është afërsisht e njëjtë me atë të Spanjës, partneriteti i saj "i pakufishëm" me Kinën vështirë se ka rëndësi në aspektin ekonomik (edhe pse gatishmëria e saj për t'u përfshirë në aktivitete përcarëse në mbarë botën, mund të jetë e dobishme për fqinjën e saj më të madh jugor). Por një vend në "luftë" ka nevojë për një strategji. Dhe SHBA-ja nuk mund ta fitojë vetmenjë garë të re midis fuqive

të mëdha. Ajo ka nevojë për miq. Aleatët e saj natyrorë janë Evropa dhe demokracitë e tjera të zhvilluara në mbarë botën.

Por Trump bëri gjithçka që mundi për t'u distancuar prej tyre, dhe republikanët – ende tërësisht të varur prej tij – kanë dhënë arsye të mjaftueshme për ta vënë në dyshim nëse SHBA është një partner i besueshëm. Për më tepër, Amerika duhet të fitojë zemrat dhe mendjet e miliarda njerëzve në vendet dhe tregjet në zhvillim në botë.

Jo vetëm për të pasur thjesht numra në anën e saj, por edhe për të siguruar qasje në burimet jetike. Për të fituar mbështetjen e shumicës së botës, SHBA-ja duhet të kompensojë shumë terren që ka humbur vitet e fundit. Historia e saj e gjatë e shfrytëzimit të vendeve të tjera nuk e ndihmon aspak.

As racizmi i saj me rrënjë të thella, të cilën Trump e përdor me mjeshtëri dhe cinizëm. Kohët e fundit, politikë-bërësit amerikanë kontribuan në "aparteidin e vaksinave", ku vendet e pasura morën të gjitha dozat e nevojshme, ndërsa njerëzit në vendet më të varfra u lanë në mëshirë të fatit.

Ndërkohë, kundërshtarët e rinj të Amerikës në Luftën e Ftohtë, i bënë vaksinat e tyre të disponueshme për të tjerët me kosto më të lirë ose nën kosto, duke i ndihmuar gjithashtu këto të fundit që të ngrënë fabrikat e tyre të prodhimit të vaksinave.

Hendeku i besueshmërisë, është edhe më i madh kur bëhet fjalë për ndryshimet klimatike, të cilat prekin në mënyrë disproporcionale ata në Jugun

Global, që kanë më pak aftësi për t'u përballur. Ndërsa tregjet kryesore në zhvillim, janë bërë burimet kryesore të emetimeve të gazrave serrë, emetimet e SHBA-së janë ende më të mëdhatë.

Vendet e zhvilluara vazhdojnë t'i shtojnë ato, dhe ç'është më e keqja, nuk i kanë përmbushur as premtimet e tyre të pakta për të ndihmuar vendet e varfra të mëdha. Vendet e zhvilluara vazhdojnë t'i shtojnë ato, dhe ç'është më e keqja, nuk i kanë përmbushur as premtimet e tyre të pakta për të ndihmuar vendet e varfra të mëdha. Vendet e zhvilluara vazhdojnë t'i shtojnë ato, dhe ç'është më e keqja, nuk i kanë përmbushur as premtimet e tyre të pakta për të ndihmuar vendet e varfra të mëdha. Vendet e zhvilluara vazhdojnë t'i shtojnë ato, dhe ç'është më e keqja, nuk i kanë përmbushur as premtimet e tyre të pakta për të ndihmuar vendet e varfra të mëdha.

Evropa dhe Amerika janë shumë të afta për t'u dhënë leksione të tjerëve, mbi atë që është moralisht e drejtë dhe ekonomikisht e arsyeshme. Por mesazhi që vjen zakonisht prej tyre është "Bëni si them unë, dhe mos bëni si bëj unë!". Sidomos pas viteve të presidencës Trump, Amerika nuk ka më asnjë pretendim për një nivel të lartë moralshmërie, dhe nuk gëzon më asbesueshmërinë e duhur për të dhënë këshilla.


Neoliberalizmi dhe politika ekonomike nga e cila përfitojnë kryesisht të pasurit, nuk u përfaquan kurrë gjerësisht në Jugun Global, dhe tani ato po dalin kudo nga moda. Njëherazi, Kina ka shkëlqyer jo në dhënie të leksioneve, por në pajisjen e vendeve të varfra me infrastrukturën jetike. Është e vërtetë, këto vende zhyten shpeshherë në borxhe. Por duke pasur parasysh sjelljen e vetë bankave perëndimore si kreditore në botën në zhvillim, SHBA-ja dhe të tjerët vështirë se janë në gjendje të drejtojnë gishtin e fajit tek Pekini.

Nëse SHBA-ja do të nisë një Luftë të Re të Ftohtë, ajo duhet ta kuptojë më mirë se çfarë iduhet për të fituar. Luftërat e Ftohta fitohen në fund me fuqinë e butë të tërheqjes dhe bindjes. Për t'ia dalë këtë herë, ne duhet ta bindim pjesën tjetër të botës të blejë jo vetëm produktet tona, por edhe sistemin social, politik dhe ekonomik që ne po u shesim.

Shtetet e Bashkuara mund të dinë se si të prodhojnë avionët bombardues dhe sistemet raketore më të mira në botë, por këto aftësi nuk do të na ndihmojnë dot në këtë sfidë. Pasi ne duhet të ofrojmë ndihmë konkrete për vendet dhe tregjet në zhvillim, duke filluar që me heqjen dorë nga të gjithë pronësia intelektuale në lidhje me vaksinat anti-Covid, në mënyrë që ata të mund të prodhojnë vaksinat dhe trajtime për veten e tyre.

Po aq e rëndësishme: Perëndimi duhet t'i bëjë edhe një herë sistemet tona ekonomike, sociale dhe politike që t'i ketë zili e gjithë bota. Në SHBA, kjo fillon me reduktimin e dhunës së shkaktuar nga armët, përmirësimin e rregulloreve mjedisore, luftimin e pabarazisë dhe racizmit, si dhe mbrojtjen e të drejtave riprodhuese të grave. Derisa sa ta kemi provuar veten të denjë për të udhëhequr, nuk mund të presim që të tjerët të marshojnë drejt nesh.

Shënim: Joseph E. Stiglitz, fitues i Çmimit Nobel në ekonomi dhe profesor në Universitetin e Kolumbias. Ish-kryekonomist i Bankës Botërore në vitet 1997-2000, dhe kryetar i Këshillit të Këshilltarëve Ekonomikë të Presidentit të SHBA-së. "Project Syndicate" – Bota.al



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJOËSIA'  
TEL: 045/82 82 82**

# KOK-u paraqiti ekipin për Lojërat Mesdhetare 'Oran 2022'

**PRISHTINË, 21 QERSHOR** - Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) ka paraqitur ekipin mesdhetar për Lojërat Mesdhetare "Oran 2022", të cilat prej 25 qershorit deri më 6 korrik do të mbahen në Oran të Algerisë. Ekipi në përbërje prej 39 sportistëve, 16 trajnerëve dhe tre gjyqtarëve, u paraqitën në ceremoninë e organizuar në "Hotel Swiss Diamond" në Prishtinë, ku i pranishëm ishte edhe kryeministri Albin Kurti dhe ministri për Kulturë, Rini e Sport, Hajrulla Çeku. Presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi, duke iu uruar fat sportistëve, theksoi se njësoj si Spanja që nuk e njeh shtetin tonë, ku katër vjet më parë u fituan katër medalje (tri të arta dhe një të argjendtë), edhe Algeria do ta njohë vendin tonë duke respektuar simbolet tona gjatë ceremonive të medaljeve.

Kryeministri Kurti deklaroi se krahas xhudos, pret që sportistët tanë t'i sjellin medalje vendit edhe nga sportet e tjera. Sekretari i përgjithshëm i KOK-ut, Besim Aliti, deklaroi se në mungesë të xhudos për ceremoninë hapëse të LM Oran 2022, flamurin tonë do ta bartin mundësi Egzon Shala dhe karateistja Fortesa Orana. Kampionia olimpikë, Distria Krasniqi, shprehi optimizëm se këtë herë do të fitohen edhe më shumë medalje. Ajo kishte fituar të artën katër vjet më parë në LM Tarragona 2018. Trajneri më i mirë i xhudos për vitin e kaluar, Driton Kuka, theksoi se, krahasuar me katër vjet më parë, këtë herë ka më shumë sportistë pretendentë për të fituar medalje. Në ceremoni, presidenti i KOK-ut, Krasniqi, ndau pinat për kryeministrin Kurti dhe ministrin Çeku, të cilët bashkërisht ndanë fanellën e Kosovës për xhudisten Krasniqi dhe mundësin Shala.

## LISTA E KOSOVËS PËR LOJËRAT MESDHEHETARE "ORAN 2022"

### Xhudo

Distria Krasniqi (-52 kg)  
Akil Gjakova (-73 kg)  
Loriana Kuka (-78 kg)  
Laura Fazliu (-63 kg)  
Flaka Loxha (-57 kg)  
Erza Muminoviq (-48 kg)  
Arbër Kullashi (-81 kg)  
Shpati Zekaj (-100 kg)  
Trajnerë: Driton Kuka dhe Majlinda Kelmendi



### Boks

Donjeta Sadiku (-60 kg)  
Bashkim Bajoku (-52 kg)  
Shpëtim Bajoku (-63 kg)  
Patriot Behrami (-69 kg)  
Lorent Murati (-57 kg)  
Trajnerë: Besim Brahimi dhe Faton Xhakli

### Mundje

Egzon Shala (-125 kg)  
Alban Sopa (-74 kg)  
Trajner: Sylejman Shala

### Karate

Elhami Shabani (-75 kg)  
Fortesa Orana (+68 kg)  
Melos Gashi (-84 kg)  
Albulenë Gërvalla (-55 kg)  
Adelina Rama (-61 kg)  
Trajner: Ylber Sylja dhe Nazmi Gashi

### Atletikë

Muhamet Ramadani (hedhje e gjylës)  
Astrit Kryeziu (800 m.)  
Gresa Bakraji (3000 m.)  
Alaudin Suma (hedhje e diskut)  
Trajnerë: Shaban Ramadani dhe Bajram Duja

### Not

Alush Telaku (flutur: 100m., 200m., 50m)  
Vanesa Beka (bretk. 50m. dhe 100m.)  
Trajner: Kujtim Kito

### Shigjetari

Hazir Asllani (70m. ind)

Edi Dvorani (70m. ind)  
Valmir Gllareva (70m. ind)  
Trajner: Fehmi Bylykbashi

### Shenjëtari Sportive

Nexhat Sahiti (10 m. pist. ajër)  
Drilon Ibrahimimi (10 m. pushk. ajër)  
Trajner: Fehmi Berisha

### Taekwondo

Arbër Azemi (-68 kg)  
Arbër Bajra (-80 kg)  
Trajner: Nuhi Gashi

### Tenis

Vesa Gjinaj  
Vullnet Tashi  
Trajner: Jeton Hadërgjonaj

### Pingpong

Fatih Karabaxhak  
Kreshnik Mahmuti  
Trajner: Dardan Imami

### Gjymnastikë

Elvis Çitaku  
Valëza Rama  
Trajner: Abelian Bregu dhe Besart Maqastena

### Badminton

Rinor Gllareva  
Trajner: Lulëzim Haziri

### Gjyqtarë

Latif Demolli (boks)  
Fatmir Salhija (xhudo)  
Besart Vitia (karate)

## SHKURT

### Jashari konfirmon largimin nga Llapi

Mbrojtësi i njohur në futbollin e Kosovës, Dardan Jashari, nuk do të jetë më futbollist i skuadrës së Llapit. Futbollisti ka konfirmuar largimin nga skuadra llapjane me anë të një shkrimi të publikuar në "Facebook". "Ju njoftoj se nuk jam më pjesë e Klubit të Futbollit Llapi. Dy trofe në Podujevë shpresoj të jenë të mjaftueshëm për një vit sa kalova këtu. Dua të falënderoj kryesinë e klubit për korrektësinë ndaj meje, stafin për mbështetjen, bashkëlojtarët për momentet që i kaluam së bashku dhe tifozët 'legjendat' për përkrahjen", ka shkruar Jashari.

### KH Prishtina vazhdon bashkëpunimin me dy lojtarë

Klubi i Hendbollit Prishtina vazhdon punën për kompletimin e skuadrës për edicionin e ardhshëm. Prishtina së fundi ka vazhduar bashkëpunimin me qendrën Vleron Zherka dhe alon Agon Bajqinovci. Zherka e Bajqinovci vlerësohen prej më të mirëve në vend në pozitat e tyre dhe pritet të jenë të rëndësishëm te Prishtina në edicionin e ardhshëm garues.

### West Hami ofron 35 milionë euro për Brojën

Armando Broja është një nga sulmuesit më të përfolur në afatin kalimtar të verës. Skuadrat e interesuara për të janë të shumta nga Italia dhe Anglia. West Hami ka befasuar Napolin dhe Atalantën dhe po përgatit një ofertë të cila mund ta "joshë" Chelsean, klubin që zotëron kartonin e Brojës. Sipas "Sky Sport", ata kanë gati një ofertë të cila sillet nga 30-35 milionë euro për t'i bindur "Blutë" e Londrës, ndërsa falë kësaj shume pretendojnë t'i parakalojnë klubet italiane të cilat vështirë se mund të shpenzojnë një shifër të tillë.

## Gjilani transferon Krivanjevan

**GJILAN, 21 QERSHOR** - Skuadra e Gjilanit ka njoftuar se ka arritur marrëveshje dyvjeçare me futbollistin Besart Krivanjeva, i cili në edicionin e kaluar ka qenë pjesë e Engatias derisa ka përvojë edhe në

kampionatin maqedonas. "Sport Club Gjilani komunikoi angazhimin e futbollistit Besart Krivanjeva. Marrëveshja e nënshkruar është e vlefshme për dy vjet dhe me mundësi vazhdimi. 26-vjeçari, i cili luan në

pozitën e mbrojtësit të qendrës, vjen nga radhët e skuadrës së Engatias në kampionatin shqiptar, derisa më parë ka mbrojtur ngjyrat e dy skuadrave nga Maqedonia e Veriut, FC Shkupit dhe Metalurgut. Të

gjithë në SC Gjilani i urojnë mirëseardhje Besartit dhe i dëshirojnë sukses në objektivat që klubi ka vënë para, duke nisur nga garat ndërkombëtare", thuhet në njoftimin e klubit nga Anamorava.



## Eto'o e pranon fajësinë: Do ta paguaj dënimin

**BARCELONË, 21 QERSHOR** - Ish-futbollisti i Barcelonës dhe Real Madridit, Samuel Eto'o, është shpallur fajtor për një mashtrim tatumor në lidhje me të drejtat e imazhit të tij në kohën kur ai luante te Barcelona. 41-vjeçari është dënuar me 22 muaj burg me kusht nga Gjykata në Spanjë.

Eto'o para trupit gjykues ka pranuar se ka fshehur 3.8 milionë euro nga autoritetet tatimore të Spanjës mes viteve 2006-2009. Tani ai duhet të paguajë atë shumë të parave, së bashku me një gjobë prej 1.8 milion eurosh. Gjykata konfirmoi se Eto'o transferoi të drejtat e tij të imazhit

në një kompani me bazë në Hungari, e cila deklaroi të ardhurat e tij në atë vend, ku norma e taksave është një nga më të ulëtat në Evropë. Ish-sulmuesi dhe tani kryetar i Federatës së Futbollit të Kamerunit e pranoi fajësinë. "I pranoj faktet dhe do të paguaj atë që më takon, por le të

dihet që atëherë isha i ri dhe se kam bërë gjithmonë atë që ish-agjenti im ka kërkuar, Jose Maria Mesalles, të cilin e konsideroja si baba. Ai më kërkoi ta bëja në atë kohë", ka thënë ish-reprezentuesi i Kamerunit. Edhe ish-agjenti i Samuel Eto'o's, Jose Maria Mesalles, u dënua me 12 muaj



burg me kusht dhe një gjobë gjithashtu.

## Nga Platini te Maradona, kur kampionët dështojnë si trajner



**PARIS, 21 QERSHOR** - Një fenomen në fushë. Në stol, një fatkeqësi. Michel Platini, i cili mbush 67 vjeç, nuk ka pasur kurrë karakteristikat e trajnerit, pavarësisht se kishte një klasë të jashtëzakonshëm në fushë. Si trajner i Francës, ai arriti të dështonte në të gjitha kompeticionet: Evropiani i 1988-s dhe Botërori 1990, pavarësisht se kishte një skuadër të shkëlqyer në dispozicion. Ai provon sërish si menaxher, por nuk i shkon shumë mirë. Me sa duket, Le Roi nuk bëri llogaritë me historinë, e cila u mëson diçka kampionëve ndër më të mirët ndonjëherë: futbollistët e mëdhenj nuk kanë arritur gjithmonë ta përsëritin veten në anën tjetër të gardhit.

### Maradona

Do të mjaftonte të mendonim për Diego Armando Maradonan, i cili në stol ka pasur gjithmonë të gjitha problemet që dukej se nuk ekzistonin në fushë për të. Diego ka pasur përvoja si trajner i Argentinës së tij, me një eliminim të bujshëm në Botërorin 2010, por edhe në shtëpi, në Gjirin Persik dhe, madje, në serinë e dytë meksikane. Zero kënaqësi për Diegon, me shumë finale të humbura dhe ngjitje në kategori të humbura në castet e fundit.

### Gullit

Karriera e Ruud Gullit dukej se ishte në një rrugë të shkëlqyer pas debutimit dhe fitores me Chelsean

në FA Cup. Por ka rezultuar të jetë e vetmja arritje teknike e holandezit, i cili është fundosur në drejtimin e Newcastle's dhe Feyenoordit. Pastaj ka ardhur një pelegrinazh i gjatë në kontinente të ndryshme nga Los Angeles në Terek Groznyj në Rusi. Jo tamam e paharrueshme si karrierë.

### Van Basten

Duke qëndruar te holandezët. Edhe Marco Van Basten, përkundër asaj që la trashëgimi si futbollist, nuk ka marrë kurrë vlerësime të mëdha si trajner. Me Holandën ai doli në 1/8-at e Kupës së Botës 2006 dhe në çerekfinalet e "Euro 2008" me Rusinë. Më pas nuk arrin të kualifikohet në Ligën e Kampionëve me Ajaxin. Me pak fjalë, jo saktësisht një listë për t'u mbajtur mend.

### Matthaus

Edhe Matthaus, numri dhjetë që e tërhoqi Gjermaninë në Kupën e Botës 1990, nuk ka mahnitur kurrë si trajner edhe nëse është ndër të paktët që ka fituar: Dy tituj me Partizanin e Beogradit dhe Salzburgun, por një seri e gjatë zhgënjimesh dhe shkarkimesh mes kombëtares bullgare dhe hungareze, të ndërthurura me përvoja negative në Brazil dhe në serinë e dytë izraelite.

### Klinsmann

Jurgen Klinsmann arrin të hyjë në histori nga dera e gabuar në dy ... botë. Në vitin 2006 ai arriti të

humbasë, nuk kishte ndodhur më parë, me kombëtaren në Dortmund gjysmëfinalen e kampionatit botëror në shtëpi, duke ua dhënë dritën jeshile "axurrëve" drejt titullit. I pakënaqur pranon të jetë trajner i ShBA-së dhe ndërpret serinë e kualifikimeve radhazi në Botëror duke u befazuar nga Panamaja. Përvoja e fundit, te Hertha, zgjat disa muaj para shkarkimit.

### Seedorf

Profesor në fushë, mediokër në stol. Clarence Seedorf, një nga mesfushorët më të talentuar të Milanit dhe ekipit kombëtar holandez, nuk ishte në gjendje t'i ndiqte gjurmët e mjeshtrit Ancelotti. I shkarkuar nga Milani, pas ulje-ngritjeve mes Spanjës dhe Brazilit, ai shkoi në gjueti për revansh në Kamerun, por kjo përfundoi shumë keq.

### Henry

Shkarkimi i Henryt nga Monaco është fundi i papritur i një përvoje tepër të keqe. Francezi shkoi për ta ringjallur klubin e Principatës, i cili nuk po shkonte mirë nën drejtimin e Jardim, dhe ... gati e bëri atë të binte nga kategoria, deri në atë pikë sa drejtuesit detyroheshin ta kthejnë trajnerin e vjetër. Titi vendos të provojë përsëri, drejton Montrealin dhe premton se e ka mësuar mësimin e tij. Por këtë herë është ai që jep dorëheqje.

## SHKURT

### Uellsit mbetet pa trajner, Giggsi jep dorëheqje

Ish-lojtari i Manchester Unitedit tashmë është edhe ish-trajner i Uellsit. Fabrizioo Romano ka bërë me dije se Giggsi ka dhënë dorëheqje nga drejtimi i kombëtares së Uellsit. "Po heq dorë nga pozicioni im si trajner i kombëtares për meshkuj të Uellsit. Ishte një nder dhe privilegj që unë të menaxhoja këtë ekip", është shprehur Ryan Giggs.

### Irvingu, afër transferimit te lakersat

Basketbollisti 30-vjeçar Kyrie Irving, kampion i NBA-së, është pranë transferimit te skuadra e lakersave. Ylli që luan me Brooklyn Netsin është pranë divorcit, pasi duket se palët nuk kanë marrëveshje për rinovimin e saj. Sezonin e fundit Irvingu luajti vetëm 29 ndeshje me Netsin, pasi është i pavaksinuar dhe nuk lejohej të aktivizohej, duke bërë lëmsh ekipin e tij. Gjithsesi, ylli i NBA-së ka një mesatare prej 27.4 pikësh për ndeshje në ato 29 takime ku u aktivizua. Për Irvingun janë interesuar tri skuadra: Lakers, Clippers dhe New York Knicks. Gjithsesi, Lakersi duket favorit dhe është LeBron ai që bën ndërmjetësin, pasi e njeh mirë këtë lojtar. Së bashku ata fituan titullin me Clevelandin në vitin 2016. Irvingu ka na favorin e tij "opcionin e lojtarit" me vlerën 36 milionë dollarë, që pritet ta shfrytëzojë për t'u larguar.

### Sterlingu pëlqen kalimin te Chelsea

Raheem Sterling është, sipas ESPN, i interesuar të bëjë një lëvizje nga Manchester City te Chelsea. Sulmuesi anglez po përballë edhe një herë me pyetjet për të ardhmen e tij te kampionët në fuqi të Ligës Premierë. Sterling është i gatshëm të kalojë te rivalët e Citizens derisa në garë për të thuhet se është edhe Arsenali. Mirëpo, "The Blues" është favoritë aktualisht për ta marrë kartonin e tij, derisa ka bërë edhe ofertën e parë rreth 25 milionë euro. Natyrisht se City e ka refuzuar ofertën e Chelseat dhe po kërkon më shumë për ta realizuar marrëveshjen. Besohet se një ofertë rreth 45 milionë euro mund ta kompletojë kalimin e Sterlingut në "Stamford Bridge".

### PSG-ja befason Barcelonën, bën gati ofertën për Lewandowskin

Humbjet financiare në sezonin e fundit për PSG-në kapën vlera të frikshme, por kjo nuk e frenon aspak klubin parisien në merkato. Ekipi francez së fundmi mësohet se ka kërkuar informacione për situatën e Robert Lewandowskit. PSG-ja është në kërkim të një sulmuesi për të formuar një dyshë të fortë me Kylian Mbappen dhe drejtuesit po marrin në konsideratë dhe një afim të mundshëm të polakut. Barcelona është ndjeshëm e avantazhuar, por situata financiare mund të bëjë që PSG-ja të përfitojë dhe të bëjë një ofertë shumë më të mirë financiare që do ta kënaqë edhe Bayernin për ta lënë të lirë.

## Mercedesi pretendon se ka tejkaluar problemet me 'turbulencë'

Skuadra e Mercedesit pretendon se po kthehet në garë për pjesën e mbetur të sezonit në Formula 1. Mercedesi ka dështuar me konceptin për W13, duke mos fituar asnjë nga nëntë garat e para

të kampionatit. Megjithatë, së fundmi nga skuadra kampione në fuqi insistojnë se problemet me 'turbulencë' (porpoising) janë tejkaluar. "Mendoj se disi kemi anashkaluar atë që e njohim si

'turbulencë' ose 'kërcim' (porpoising-bouncing). Kjo ka të bëjë me aerodinamikën dhe lëvizjen e bolidit. Mendoj se kemi zgjidhur këtë problem", ka thënë Toto Wolff. "Unë mendoj se thjesht

duhet të vendosim më shumë ngarkesë dhe, po ashtu, ta bëjmë këtë një makinë që nuk është aq e ulët sa prisnim. Është një drejtim i qartë; ju mund të shihni që bolidët shkojnë më lart. Dhe këtu duhet ta

gjejmë performancën", ka shtuar shefi i Mercedes në F1. Mercedesi vazhdon të jetë pa fitore në këtë edicion në Formula 1. Ai po synon të bëjë diçka më shumë me Silverstonen.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se “Ordinanca Logopedike Logopedia M ” SH.P.K. Pronar Meriton Bahtiri Vushtrri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. Unik Identifikues: 811356022 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Ordinanca Logopedike Logopedia M ” D.O.O. Meriton Bahtiri Vushtrri, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811356022 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

All clients are to be informed that the “Ordinanca Logopedike Logopedia M” L.L.C. Meriton Bahtiri Vushtrri, has come to the decision to quit its business: 811356022 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- ▶ Lisjan Caka shpall të pavlefshme Diplomën e shkollës së mesme të Gjimnazit “MehmetAkif College” Lipjan.
- ▶ Marin Caka shpall të pavlefshme dëftesën e kl, njëmbëdhjetë të Gjimnazit “MehmetAkif School” drejtimi shkencat e natyrës, Lipjan.
- ▶ Marin Caka shpall të pavlefshme dëftesën e kl, dhjetë të Gjimnazit “MehmetAkif School” drejtimi shkencat e natyrës, Lipjan.
- ▶ Flora Ajeti shpall të pavlefshme dëftesat e vitit të I, II të Gjimnazit “Gjin Gazulli” Prishtinë.
- ▶ VTD Sh.p.k me nr. Biznesit 810869943 me adresë rr. Bajram Kelmendi nr.40 Prishtine, shpall te pavlefshme certifikatën e TVSh-së
- ▶ Kaltrina Bllata shpall të pavlefshme ID-kartelën me numër: RE-98445\19, Fakulteti i Gjuhës Angleze të Kolegjit “AAB” në Prishtinë.
- ▶ Milot Hajdari nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.E “Kadri Kusari” Gjakovë.
- ▶ Emine Mamusha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit “Fehmi Agani” me nr: 707 – drejtimi MAMI.
- ▶ Auron Doli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës së – X-, -XI-, -XII-, diplomën dhe certifikatën e maturës të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- ▶ Petrit Rizvanolli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës: -X-, dhe -XII- dhe diplomën e SH.M.Ekonomike “Kadri Kusari”, Gjakovë.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



**Gjeje PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejepuneshpeite](http://www.facebook.com/gjejepuneshpeite)

**RESTAURANT**

**SWISS**

**TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

